



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.02.2025
Numër Protokolli: 2053/2025

A.nr.111/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.111/2025, të datës 16.01.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B., kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.111/2025, e datës 16.01.2024, e parashtruar nga ankuesi A.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me Nr. protokolli 14-111/01-0168221/24, i datës 20.12.2024, i Sektorit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtar në procedurën e pranimi me numër të referencë: RN00015474, pozita e punës Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.B. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 15.01.2025, përmes adresës elektronike të KPMSHCK (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 16.01.2025, nën shenjë A.nr.111/2025, kundër konkursit me Nr.Ref: RN00015474, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, i shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 21.01.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 201/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 16.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 25.11.2024; Njoftimi me Nr. protokoli 14-111/01-0168221/24 i datës 20.12.2024 i Sektorit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës për shpalljen e rezultatit përfundimtar; Konkursin me Nr. Referencë: RN00015443, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, si shpallur nga Komuna e Prishtinës; Konkursin me Nr. Referencë: RN00015474, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, si shpallur nga Komuna e Prishtinës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin e datës 14.10.2024 për anulimin e konkursit të datës 12.10.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 21.01.2025; Vendimin me Nr. 14-020/04-0152052/24 të datës 15.11.2024 për përbërjen e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtareve të komisionit; Listën e apkikantëve; Listën e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 20.12.2024; Esenë e ankuesit dhe kandidatit fitues; Formularët e datës 16.12.2024 për vlerësimin e esesë për ankuesin dhe kandidatit fitues; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë datës 20.12.2024 për ankuesin dhe kandidatit fitues; Aplikacionin e kandidatit fitues datës 11.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-60; Aplikacionin e ankuesit i datës 30.10.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-47.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës del se Komuna e Prishtinës më datë 14.10.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00015474, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, klasa Drejtues i ulët, ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.10.2024 deri më 13.11.2024.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa, në fazën e verifikimit paraprak kanë kaluar vetëm pesë (5) kandidatë, përfshirë ankuesin i cili dhe i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional.

Rrjedhimisht, sipas njoftimit Nr. protokoli 14-111/02-0168221/14, të datës 20.12.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të organit të punësimit, si kandidat fitues në këtë procedurë është shpallur L.Sh. me 96 pikë, ndërsa, sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi ka marr gjithsej 77.4 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë më shumë pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se fillimisht më datë 12.10.2024, është shpallur konkursi për këtë pozitë me kriteret Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, por është anuluar, duke u rishpall më datë 14.10.2024, ku është shtuar drejtimi Inxhinier i Komunikacionit dhe Telekomunikacionit duke iu përshtatur pikërisht kandidatit fitues; Vlerësimi i esesë nuk ka qenë objektiv pasi që kandidati fitues është vlerësuar me maksimumin e pikëve ndërsa unë jam vlerësuar me 14 pikë, e kur dihet se kam master të shkencave teknike të ndërtimtarisë. Kërkon që të shfuqizohet njoftimi i datës 20.12.2024.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit më Nr. ref. RN00015474, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).

Kërkesat specifike: Diplomë universitare: Drejtimi: Inxhinier i Ndërtimtarisë, Inxhinier i Arkitekturës, Inxhinier i Komunikacionit dhe Telekomunikacionit. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës..

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- **Nenit 39 paragrafi 1:** 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.

- **Nenit 44 :** 1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në uebfaqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në uebfaqen e institucionit përkatës.

Po ashtu për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

- **Nenin 7 :** 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.

- **Nenin 8:** Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.

Rrjedhimisht, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor të KPMSHCK-së për sigurimin e rregullave dhe parime të shërbimit civil si dhe ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Organi publik përcakton, në mënyrë të

pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në këtë procedurë të pranimit e kontestuar me ankesë, dhe si rrjedhojë Kolegji nga analizimi i kriterëve të përgjithshme formale ka konstatuar se kriteret për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta, klasa Drejtues i ulet, janë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Përbërja e Komisionit të Pranimit i themeluar më Vendimin e datës 15.11.2024 të Kryetarit të Komunës, ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore të përcaktuar më nenin 45 paragrafi 2 të Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor referuar vlerësimit jo objektit të eses duke pretenduar që kandidati fitues është vlerësuar me maksimumin e pikëve ndërsa ankuesi më vetëm 14 pikë, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se kandidati fitues në testin me shkrim ka marr gjithsej 67 pikë, gjegjësit në përgjigjet më zgjidhje të shumëfishta ka arrit 48 pikë nga maksimumi i 50 pikëve, ndërsa në ese është vlerësuar më 19 nga maksimumi i 20 pikëve, kurse ankuesi në testin me shkrim ka marr gjithsej 52.8 pikë, ashtu që në përgjigjet më zgjidhje të shumëfishta ka arrit 38 pikë, ndërsa në ese është vlerësuar më 14.8 pikë, nga maksimumi 20 pikë, andaj, edhe nga analizimi i trajtimit të eses nga ankuesi dhe kandidati fitues Kolegji i Këshillit, nuk vëren te meta në vlerësimin e drejt apo vlerësim diskriminues të ankuesit në raport me kandidatin fitues.

Lidhur me vlerësimet në intervistën më gojë, Kolegji ka vërtetuar se ankuesi është vlerësuar më 24.6 pikë, kurse kandidati fitues më 29 pikë, ndërsa duke qenë se vlerësimi lidhur me përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit, është vlerësim diskrecional, atëherë edhe Kolegji nuk mund te argumentoj nëse ka pas vlerësim jo real të ankuesit apo vlerësim favorizues të kandidatit fitues kandidatë. Mirëpo nga analizimi i vlerësimit lidhur me jetëshkrimin dhe duke i shqyrtuar edhe dokumentacionin e ankuesit dhe kandidatit fitues lidhur më arsimimin, përvojën e punës dhe trajnimet, ankuesi dhe kandidati fitet janë vlerësuar më pikë të njëjtë gjegjësisht me pikë maksimale.

Lidhur me pretendimin se ankuesi ka pasur diplomë të studimeve master, Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje më këtë pretendim thekson faktin e pakontestueshëm se në këtë procedurë nuk është kërkuar që kandidatet të kenë diplomë të studimeve master, andaj edhe vlerësimi i jetëshkrimit behet vetëm në raport me kërkesat formale të përcaktuar me konkurs.

Në kuptim të parimit të meritokracisë si parim bazë në procedurën për pranim në shërbim civil, Kolegji analizoj dosjen e kandidatit fitues nga dhe konstatoj se i njëjti posedon Diplomën me Nr. 496 të datës 08.04.2014, për përfundimin e studimeve themelore më datë 19.12.2013, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marr titullin Bachelor i Inxhinierisë Mekanike. Lidhur me përvojën e punës pas diplomimit, ka deponuar si dëshmi referencat nga kompanitë private si referencën e lëshuar nga Kompania RSM Company sh.p.k, me të cilin konfirmohet se kandidati L.SH nga data 01.09.2014 deri më datë 30.04.2023 ka punuar në këtë kompani i angazhuar si menaxher i projekteve si dhe referencën e punës të datës 29.01.2015, të lëshuar nga IMK Pipe Factory” L.L.C , më të cilin konfirmohet se kandidati fitues ka qenë i angazhuar në këtë kompani si Drejtor i Operimeve nga data 30.06.2011 deri 01.08.2014, përvojë të cilën e ka shqipëruar edhe më Pasqyrën e Trustit Pensional. Po ashtu, ka ofruar si dëshmi edhe referencën e datës

28.10.2024 të lëshuar nga Komuna e Prishtinës, e sipas të cilës rrjedhë së kandidati L.SH nga data 05.04.2023 është i angazhuar në Komunën e Prishtinës si Ekspert. Pra, nisur nga kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidati i shpallur fitues L.Sh. ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë së i njëjti në fazën e vlerësimit ka arritur gjithsej 96 pikë të përgjithshme, duke u renditur si kandidati me më së shumti pikë të mbledhura, atëherë, konsiderohet edhe si kandidat i suksesshëm për këtë procedurë të pranimit, kështu që edhe njësia përgjegjëse në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës ka vepruar pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndaj, siç u konstatua më sipër, gjegjësisht duke qenë së nuk janë evidentuar shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së procedura e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00015474, për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulëta i shpallur nga Komuna e Prishtinës, është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që, bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, me numër A.nr.111/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.B;
- Udhëheqëses të Njesisë së Birimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.